



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
MINISTRIA E ARSIMIT, E SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION



ARSIMI PROFESIONAL NË KUSHTE PANDEMIE





ARSIMI PROFESIONAL NË KUSHTE PANDEMIE



Përgatitur për botim nga:

Stafi i AAAPARr-së

Botues:

Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAAPARr)

Ndërtesa: MASHT, II, pranë Fakultetit Ekonomik dhe Juridik, kati III

Rr. “Agim Ramadani”, p. n., Prishtinë

Përmbajtje

Fjala e Drejtoreshës.....	5
Hyrje	10
Aktivitetet e realizuara nga Agjencia gjatë vitit 2020	11
Shkollat partnere të AAAPARr-së në procesin e validimit dhe akreditimit.....	18
Hapja edhe e tri Qendrave të Karrierës në Qendrat e Kompetencës.....	20
Memorandum mirëkuptimi me projektin ALLED2.....	21
Zbatimi i nivelit të pestë të kualifikimeve.....	22
Marrëveshje bashkëpunimi me shkollën SEDU - Finlandë.....	23
Ministrja Bajrami vizitoi Agjencinë e AAAPARr-së.....	25
Auditimi i performancës së AAAPARr-së nga Zyra Kombëtare e Auditimit	26
Efektiviteti i ndërlidhjes së arsimit dhe aftësisë profesionale me nevojat e tregut të punës	26
Vizita e Ministrit Likaj në AAAPARr	27
Marrëveshje bashkëpunimi me projektin EYE.....	28
Marrëveshje bashkëpunimi me organizatën DVV international.....	29
Marrëveshje bashkëpunimi me organizatën KCDF	31
Marrëveshje bashkëpunimi në mes të DKA-së në Prishtinë dhe AAAPARr-së	32
Qendrat e Kompetencës dhe respektimi i masave kundër Covidit.....	34
Zhvillimi i mësimin online në Qendrat e Kompetencës në kushte të pandemisë Covid-19.....	36
Vizitë në Qendrat e Kompetencës me zëvendësministrin e MASH-it, z. Xhavit Rexhaj.....	37
Zbatimi i praktikës profesionale në Qendrat e Kompetencës	39
Nxënësit e shkollës “Shtjefën Gjeçovi” i dhuruan MASH-it, 200 maska anti-COVID.....	41
Marrëveshje me organizatën DEKRA Akademi	42

Vizita e Ministrit të MASH-it, z. Ramë Likaj, në ShMLP “Shtjefën Gjeçovi”, Prishtinë	43
AAAPARr fiton projekt për mobilitet në AAP nga Komisioni Evropian.....	44
AAAPARr harton pakon kurrikulare dhe pakon e trajnimit për orientim në karrierë	45
Takim online organizuar nga EVBB me Agjencinë Evropiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (EU-OSHA).....	46
Konferencë online “ Cilësia në AAP në mjedisin POST – COVID: Rasti i Bequal. App”.....	47
Marrëveshje bashkëpunimi me BSCK.....	49
Themelohet Qendra e Karrierës në Qendrën e Kompetencës, Skenderaj.....	50
Takim pune me Dhomën Zejtare të Koblez – Gjermani (HWK)	52



Fikrije Zymeri

u. d. e drejtorit të përgjithshëm të AAAPARr-së

Fjala e Drejtoreshës

Situata në Kosovë e krijuar nga Covid-19 nga data 13 mars 2020 ka rezultuar me mbylljen e përkohshme të shkollave të mesme profesionale dhe Qendrave të Kompetencës (QK), me qëllim të mbrojtjes së shëndetit publik në Kosovë dhe ndalimit të përhapjes së mëtutjeshme të virusit “Korona”.

Pandemia e shkaktuar nga Covid-19 në mbarë botën ka ndikuar në të gjitha sferat jetësore, duke e ndaluar krejtësisht ose pjesërisht funksionimin e tyre.

Dokumenti bazë i përpiluar për këtë situatë është: “Udhëzuesi i Ministrisë së Arsimit dhe

Shkencës (MASH) për organizimin e **mësimit për vitin shkollor 2020/2021 në kushte të pandemisë** Covid-19 në Republikën e Kosovës:

Qendrat e Kompetencës, pas marrjes së vendimit për ta aplikuar formën online të mësimdhënies dhe mësim nxënies, i kanë marrë përgjegjësitë e veta dhe i kanë kryer detyrat që kanë dalë nga vendimmarrjet e institucioneve përkatëse.

Në kuadër të AAAPARr-së dhe Qendrave të Kompetencës janë themeluar task-forcat.

Shkollat kanë monitoruar zbatimin e masave dhe kanë raportuar gjendjen në shkolla siç janë kushtet higjienike dhe rastet eventuale. Task-forcat kanë mbajtur përgjegjësi të plotë rreth raportimit të gjendjes aktuale në shkolla.

Menaxhmenti i Qendrave të Kompetencës ka informuar edhe për zbatimin e kurrikulës dhe u është përmbajtur udhëzimeve metodologjike për secilin skenar, pra shkolla ka vendosur për mënyrën e zbatimit të skenarëve (mësim në shkollë, mësim online apo mësim i kombinuar), metodologjinë arsimore dhe orarin mësimor. Gjithashtu, për shkak të gjendjes shëndetësore të disa mësimdhënësve janë bërë zëvendësime me mësimdhënës të tjerë sipas nevojës dhe mundësive që kanë pasur shkollat. Janë mundësuar edhe trajnime nga mësimdhënësit e TIK-ut për disa mësimdhënës për t'iu përshtatur mësimit online dhe ndryshimeve të tjera në procesin mësimor. Në mësim online janë përfshirë të gjithë mësimdhënësit (dhe të gjithë nxënësit. Përkundër përfshirjes së të gjithëve, ka qenë gjithnjë sfiduese dhe ka pasur faktorë të jashtëm që kanë vështirësuar apo dhe pamundësuar mbajtjen e orëve mësimore, si: energjia elektrike, rrjeti i internetit, defektet, viruset, problemet e tjera) që kanë ulur dukshëm efikasitetin dhe efektivitetin në mësimdhënie dhe mësim nxënie.

Megjithatë, AAAPARr, pavarësisht prej kësaj gjendjeje pandemie, ka arritur rezultate sa i përket zbatimit të kornizave ligjore.

Duke pasur parasysh se organizimi i të mësuarit online (në distancë) ka sfida, ai mund të përmirësohet me disa propozime për përmirësimin e tij si në vijim:

- Hartimi i programeve elektronike të mësimit dhe zbatimi i platformave elektronike të përshtatura me nevojat e shkollave;
- Identifikimi i nxënësve me vështirësi të qasjes në internet apo mungesë të kompjuterëve nëpër shtëpitë e tyre;
- Organizimi i praktikës profesionale;
- Përdorimi i një aplikacioni të licencuar (siç është rasti, për shembull, me përdorimin e kufizuar

të aplikacionit zoom.us), duke i ofruar shkollës qasje përmes tre userëve, një për klasë të 10-ta, një për klasë të 11-ta dhe një për klasë të 12-ta;

- Mundësia e qasjes së nxënësve nga kompjuteri, llaptopi, tableti apo telefoni;
- User për secilin nxënës për t'iu qasur asaj platforme;
- User për secilin mësimitdhënës me privilegje të mësimitdhënësit të asaj platforme;
- Manualin për përdorimin e platformës;
- Orarin e mësimit;
- Vjeggëzat për t'iu qasur mësimit online;
- Përmirësimin e mënyrës së vendosjes së detyrave nga ana e mësimitdhënësve për nxënës;
- Përmirësimin e mënyrës së vendosjes së zgjidhjeve të detyrave nga nxënësit;
- Videot e incizuara të secilës ligjëratë online që organizohet nga ana e mësimitdhënësve për mundësi qasje edhe pasi të përfundojë ligjëratat (për ata nxënës që nuk kanë mundur ta ndjekin ligjëratën për arsye teknike);
- Vlerësimi i nxënësve online - ditari online;
- Mundësia e krijimit të testit online për vlerësim;
- Regjistrimi i vijueshmërisë së nxënësit përmes dhe në data bazën e platformës;
- Mungesa e pajisjeve të teknologjisë informative të një pjesë e mësimitdhënësve dhe nxënësve (telefonat e mençur, tabletat, kompjuterët etj.);
- Mungesa e rrjetit të internetit të një pjesë e nxënësve, një pjesë e të cilëve jetojnë nëpër vise rurale dhe nuk kanë qasje në internet;
- Mungesa e njohurive të duhura në teknologji informative të disa mësimitdhënës;
- Disa lëndë profesionale, për shkak të specifikave të tyre, nuk është fare e lehtë të organizohen përmes të mësuarit në distancë;
- Struktura e nxënësve (interesimi) në nivel jo të kënaqshëm.

Gjatë kësaj periudhe janë identifikuar vështirësitë e mësimitdhënësve:

- Mësimitdhënësit, jo të gjithë, në ditët e sotme kanë nga një kompjuter personal, laptop, telefon të mençur, televizor. Këto mjete teknologjike plotësojnë kushtin për të ligjëruar në distancë në kushte shtëpie. Vlen të theksohet se mësimitdhënësit përdorin më së shumti laptopët për mësimitdhënie, ndërsa telefonin e mençur për bashkëbisedim/bashkëveprim;
- Interneti jo i mirë në vendin ku jetojnë disa mësimitdhënës, në zona rurale;
- Mos angazhimi i disa nxënësve në aktivitetin ditor të mësimitdhënies & bërjen e detyrave të

caktuara;

- Ligjërimi i instruksioneve për gjithë përfshirje në praktikën profesionale;
- Bashkëpunim i dobët i nxënësve shumë të mirë me nxënësit që qëndrojnë në nivelin e mjaftueshëm për një arritje mesatare të kënaqshme gjithëpërfshirëse;

Vështirësitë e nxënësve janë identifikuar:

- Nxënësit qëndrojnë në të njëjtën situatë sikurse mësimdhënësit, vetëm se nxënësit më së shumti përdorin telefonin, ndërsa më pak kompjuterët personalë, laptopët apo mjetet e tjera teknologjike të cilat mund t'i kenë për bashkëbisedim dhe bashkëveprim me mësimdhënësit sa i përket mësimin në distancë;
- Interneti jo i mirë në vendin ku jetojnë shumë prej nxënësve, kryesisht në zona rurale;
- Bashkëpunim i dobët i nxënësve me njohuri të fuqishme me nxënësit që kanë njohuri elementare rreth platformave apo aplikacioneve të ndryshme rreth mësimin në distancë;
- Mësim shtesë për nxënësit me nevoja të veçanta (me autizëm), me shikim të dobët, me dëgjim të dobët;
- Mungesë e literaturës adekuate për praktika profesionale, pasi disa nxënës kanë njohuri minimale rreth gjuhëve të huaja.

Cilat do të ishin propozimet afatshkurtra për mësimdhënësit e praktikave profesionale?

- Krijimi i grupeve punuese për krijimin e literaturës adekuate për praktika profesionale;
- Kujdestarët e klasave t'i nxisin nxënësit me nivel të shkëlqyeshëm që ta rrisin bashkëpunim me çdo nxënës tjetër që ka nevojë ta ngrehë nxënien rreth mësimin të të gjitha lëndëve;
- Kujdestarët e klasave t'i këshillojnë të gjithë nxënësit e tyre që ta përdorin më shumë laptopin apo kompjuterin, për të qenë më afër veglave dhe mundësive interaktive;
- Kujdestarët e klasave, në lidhje me nxënësit me nevoja të veçanta, t'i lajmërojnë të gjithë mësimdhënësit se cilëve nxënës t'u mbahet mësim shtesë.

Propozim afatshkurtër për nxitje të të nxëniet nga nxënësit:

- Një pjesë e nxënësve janë aktivë në procesin e mësim nxënies në distancë, mirëpo ata kanë nevojë për:
- Trajnime, konferenca (punëtori) online të ndryshme për përdorimin e të gjitha mundësive për dorëzimin e detyrave, ngarkimin e tyre nëpër platforma;
- Mbështetja rekomandohet të ndodhë nga ana e mësimitdhënësve me përvojë në fushën e teknologjisë;
- Nxënësit për nxënësit (nxënësit me më shumë përvojë në përdorimin e teknologjisë) në lidhje me përdorimin e të gjitha platformave për përkrahje të mësimit në distancë, pro ngritjes së cilësisë në arsim.

Hyrje

Në periudhën janar-dhjetor në vitin 2020 është vazhduar zbatimi i dispozitave që dalin nga Ligji për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur nr. 04/L-138, në bazë të të cilit është themeluar dhe zhvillon aktivitetet Agjencia e AAPARr-së.

Gjatë këtij viti fillimisht në fokus ka qenë përgatitja për përfundimin sa më të suksesshëm të vitit shkollor 2019/2020, i cili ka qenë mjaft sfidues për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia Covid-19. Mësimi online është mbajtur në të gjitha Qendrat me një pjesëmarrje të mirë të nxënësve, që dëshmojnë raportet e rregullta të dërguara nga menaxhmenti i shkollave.

Në bazë të udhëzimeve që kanë dalë nga MASH-i, shkollat kanë përfunduar këtë vit shkollor dhe është shpallur konkursi për regjistrim të nxënësve në klasat e X-ta.

Në bashkëpunim me MASH-in, donatorin e Qeverisë së Luxemburgut Lux-Dev dhe shkollat partnere është vazhduar ofrimi i kualifikimit për asistentë për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore në Qendrën e Kompetencës (QeK) në Ferizaj, në paralelet e ndara në Qendrën Burimore “Përparimi” në Prishtinë dhe në Qendrën Burimore “Xheladin Deda” në Pejë, për vitin shkollor 2019/2020 për nivelin e pestë të arsimit sipas KKK (Korniza Kombëtare e Kualifikimeve), arsim ky i cili për herë të parë po ofrohet në Qendrat e Kompetencës në nivel vendi.

Po ashtu, një dimension të aktivitetit e kemi orientuar drejt përgatitjeve për vitin e ri shkollor 2020/2021 duke bërë planifikimet për regjistrimin e nxënësve sipas kërkesës dhe njoftimeve të MASH-it, përgatitjet për shpalljen e konkurseve për rekrutimin e personelit mësimdhënës në ato shkolla ku ka pasur nevojë. Gjithashtu, në këtë fazë kemi koordinuar dhe vazhdojmë ta japim ndihmesën profesionale që të bëhen organizimet e aktiviteteve shkollore.

Është vazhduar realizimi i aktiviteteve të planifikuara në sektorin e administratës dhe financave, të cilat janë bazuar në planin vjetor të punës së Agjencisë në harmoni me shkollat që Agjencia e AAPARr-së ka në menaxhim. Po gjatë këtij viti të punës është bërë planifikimi, ndarja e buxhetit në bashkëpunim me menaxhmentin e shkollave partnere të Agjencisë, planifikimi dhe

dërgimi në MASH i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH-it). Po ashtu, është filluar të punohet edhe në qarkoren e parë buxhetore sipas udhëzimeve të dërguara nga MASH-i dhe Ministria e Financave.

Edhe gjatë këtij viti u kemi dërguar kërkesa institucioneve relevante për buxhet shtesë dhe kërkesa të tjera të cilat janë të domosdoshme për Agjencinë dhe shkollat partnere - Qendrat e Kompetencës.

Gjatë kësaj periudhe të vitit shkollor 2019/2020 janë bërë dhe vazhdojnë të bëhen hapa përpara duke ndihmuar dhe aftësuar menaxhmentin e shkollave për përzgjedhjen e personelit të mësimdhënësve dhe atë administrativ në përputhje me kornizat ligjore. Po ashtu, janë duke u bërë hapa përpara në drejtimin e trajnimit të stafit të shkollave partnere për sistemin e menaxhimit të financave të Kosovës (SIMFK) Free Balance. Në këtë mënyrë janë aftësuar dhe po vazhdojnë të aftësohen menaxhmenti dhe stafi administrativ për përdorimin e këtij sistemi në mënyrë që pagesat për shpenzimet e buxhetit të kryhen nga vetë shkollat bazuar në kërkesat e tyre dhe gradualisht të bëhet decentralizimi i elementeve të mundshme të ligjshme në shkolla.

Aktivitetet e realizuara nga Agjencia gjatë vitit 2020

- Përgatitja e planit vjetor të punës së Agjencisë për vitin 2020, në kuadër të planit të përgjithshëm të MASH-it. Harmonizimi i këtij plani është duke u bazuar në dokumentet strategjike të MASH-it dhe të Qeverisë së Kosovës sa iu përket objektivave dhe aktiviteteve të AAP-së;
- Gjatë periudhës gjashtëmujore janë mbajtur takime në bazë të agjendës në shkollat tona partnere lidhur me fillimin e gjysmë vjetorit të dytë mësimor; rezultatet mësimore të gjysmë vjetorit të parë të këtij viti shkollor; koordinimi i planeve vjetore të shkollave me planin vjetor të Agjencisë; Bashkëpunimi dhe koordinimi i punëve dhe aktiviteteve në mes të shkollave dhe Agjencisë etj;
- Përfaqësues të AAAPARr-së kanë marrë pjesë në takime, punëtori të ndryshme që

janë realizuar nga institucione vendore dhe ndërkombëtare në lidhje me AAP-në në Kosovë.

- Zyrtarët profesionalë kanë qenë pjesë e komisionit vlerësues për rekrutimin e stafit të shkollave partnere të Agjencisë;
- Janë organizuar takime monitoruese për monitorimin e kualifikimi të nivelit të pestë për Asistentë/Fëmijë me nevoja të veçanta arsimore. Në kuadër të këtij komisioni janë mbajtur takime të rregullta dhe janë vizituar ndjekësit e këtij kualifikimi;
- Pjesëmarrje në takimet e MASH-it për PSAK;
- Pjesëmarrje në punëtorinë “Rinia, punësimi dhe shkathtësitë” lidhur me përpilimin e një analize të punësimit dhe tregut të punës nga GIZ dhe Riinvest;
- Mbledhja e të dhënave për trajnimet e mësimdhënësve, ku në bashkëpunim me MASH-in pjesëmarrës në trajnimin “Udhëheqja arsimore” ishin edhe përfaqësues të QK-ve;
- Mbledhja e të dhënave për sigurimin e cilësisë nga koordinatorët e cilësisë;
- Takim me përfaqësues të projektit Alled 2, ku janë nënshkruar edhe marrëveshje bashkëpunimi, për t’u përkrahur shkollat partnere të AAAPARr-së;
- Takim me grupin punues në Gërmi për rregullimin e UA për ndarje të bursave për femra dhe drejtime deficitare;
- Pjesëmarrje në konferencën e nivelit të lartë me titull “Ballkani perëndimor në tregje globale: Mundësi të reja për tregti dhe investim”;
- Kompletimi i raportit rreth akreditimit të QK-ve, ku janë shqyrtuar sfidat rreth aplikimit, si dhe mundësitë e përmirësimit të këtyre sfidave;
- Vizita e Ministres së MASH-it Hykmete Bajrami në AAAPARr, ku është diskutuar rreth arsimit profesional;
- Pjesëmarrje në takimin e MASH-it organizuar nga Lux - Dev, ku është diskutuar për 4 kualifikimet e reja: Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit, ngrohjes dhe klimatizimit;

Metalpunues dhe saldues; Instalues elektrik dhe Teknik i izolimit të ndërtesave (profil i ri). Aktualisht grupet e ekspertëve kanë zhvilluar standardet e profesionit dhe në ditët në vijim do të fillohet zhvillimi i kurrikulave bërthamë dhe materialeve mësimore;

- Kompletimi i të dhënave për auditim, ku është bërë auditimi i AAAPARr-së dhe shkollave partnere;
- AAAPARR, në bashkëpunim me institucione të ndryshme, ka aplikuar në projekte të ndryshme ndërkombëtare, për të përfituar projekte në mënyrë që QK-të të përkrahen për një arsimim sa më të mirë, si me projektin REA Prishtina etj;
- Është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit në mes të Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAAPARr) dhe EYE (Projekti Rritja e Punësimit për të Rinj (EYE)), i zbatuar nga konsorciumi Helvetas Swiss Intercooperation (HSI) dhe Management Development Associates (MDA). Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit (“MM”) është realizimi i projektit “Ofrimi i kursit trajnues të shkurtër të orientimit për karrierë” për kualifikimin e stafit të Qendrave Shkollore për Karrierë (QShK) dhe grupeve të ndryshme të të rinjve dhe të rriturve.

Në veçanti, përmes kësaj MM-je midis palëve synohet:

Objektivi 1. Akreditimi nga AKK i kursit trajnues të shkurtër të orientimit për karrierë;

Objektivi 2. Ngritja e kapaciteteve të trajnerëve në Qendrën e Kompetencave në Prizren për ofrimin e kursit trajnues të shkurtër të orientimit për karrierë;

Objektivi 3. Ofrimi i qëndrueshëm i kursit trajnues të shkurtër të orientimit për karrierë nga Qendra e Kompetencës në Prizren.

- Është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit në mes të Fikrije Zymberit, u. d. e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAAPARr) dhe Ramadan Alija nga DVV Internacional;

Kjo marrëveshje bashkëpunimi ka për qëllim digjitalizimin e Qendrës së Kompetencës në Prizren dhe të Qendrës së Kompetencës në Malishevë, si dhe do të mundësojë zhvillimin e dy platforma vet elektronike për mësimin online dhe për furnizimin me pajisje të nevojshme të këtyre dy Qendrave të Kompetencës;

- Është vazhduar implementimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit në mes të Agjencisë së Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit të Rriturve dhe Lux/Development në emër të Projektit KSV/020 “Mbështetja për reformën e arsimit dhe aftësimin profesional në Kosovë”, faza 2, për realizimin e mbështetjes në Qendrat e Kompetencës në Ferizaj, Prizren, si dhe në shkollat e mesme të larta profesionale “Shtjefën Gjeçovi” në Prishtinë dhe “11 Marsi” në Prizren;
- Gjatë periudhës së pandemisë, gjashtë shkollat partnere të AAAPARr-së kanë qenë ndër shkollat e para në Kosovë që e kanë realizuar mësimin në distancë, ku përmes programit Zoom mësimdhënësit kanë realizuar programin e tyre mësimor;
- Është siguruar buxheti për sigurimin shëndetësor të nxënësve për praktikën profesionale;
- Funkcionalizimi i tri Qendrave të Karrierës në Qendrën e Kompetencës në Malishevë, në ShMLT “11 Marsi” në Prizren si dhe në ShMLP “Shtjefën Gjeçovi” në Prishtinë. Kjo është realizuar në bazë të marrëveshjes së nënshkruar në mes të AAAPARr-së dhe projektit EYE për hapjen e qendrave të karrierës;
- Është duke u punuar për hapjen edhe të tri qendrave të reja për karrierë, në tri shkollat partnere: në Qendrën e Kompetencës në Prizren, Ferizaj dhe Skenderaj;
- Vlerësimet vjetore për menaxhmentin e shkollave partnere të AAAPARr-së për vitin 2019;
- Përgatitja e planit të personelit sipas kërkesave të MAP për vitin 2020;
- Përgatitja e planit për trajnimin e stafit të AAAPARr-së nga IKAP për vitin 2020;
- Përgatitja e statistikave për vlerësimet e performancës së stafit të Agjencisë dhe

- shkollave partnere për vitin 2019 për dërgim në MAP;
- Përgatitja dhe procedimi i ndryshimeve të muajit për listën e pagave për stafin e shkollave partnere, sipas kërkesave të shkollave partnere dhe stafin e Agjencisë;
 - Përgatitjet për fillimin e regjistrimit të nxënësve për vitin shkollor 2020/2021;
 - Përgatitja e draft/marrëveshjeve për marrjen nën menaxhimin e Agjencisë të dhjetë shkollave të tjera profesionale;
 - Përmbledhja dhe finalizimi i të dhënave për shkollat profesionale në shtatë (7) komunitet e Kosovës, të harmonizuara me politikat e reja të Agjencisë sipas KASh-it, 2021/2023;
 - Përgatitja e lëndëve për auditim nga Auditori i përgjithshëm;
 - Procedimi i kërkesave për vendime për pushime të lehonisë dhe pensionim të stafit të shkollave partnere;
 - Shkresat për gjykatat dhe Inspektoratin e Punës lidhur me pagesën e shujtave dhe pagesën e udhëtimeve për mësimdhënësit e shkollave partnere;
 - Shkresa për Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës lidhur me kërkesat për lejimin dhe buxhetimin e disa kategorive ekonomike;
 - Takim me menaxhmentin e shkollave partnere të Agjencisë së AAPARr-së lidhur me çështjet e administratës dhe financave;
 - Përgatitja e KASh-it për vitet 2021/2023;
 - Shpallja e konkursit dhe zhvillimi i procedurave sipas kërkesave të menaxhmentit të “11 Marsi” në Prizren, Qendrës së Kompetencës në Skenderaj dhe ShMLP “Shtjefën Gjeçovi” në Prishtinë për plotësim të vendeve të punës pas pensionimit të mësimdhënësve;
 - Procedimi i pagesave për arsimin e të rriturve si dhe kërkesës për rritjen e kufijve për këtë kategori buxhetore;
 - Kërkesa drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për

lirimin e 39 normave të mësimdhënësve të ShMLP “Ymer Prizreni” të cilat gjenden në listën e pagave të Agjencisë;

- Shkresë drejtuar menaxhmentit të QeK-ve lidhur me promovimin e profileve për regjistrim të nxënësve për vitin shkollor 2020/2021;
- Përgatitja e dosjes me të dhëna të kërkuara për auditorin e jashtëm;
- Përgjigje në kërkesat e mësimdhënësve të shkollave partnere lidhur me pagat jubilarë, shpenzimet e udhëtimit dhe shujtat;
- Shkresat për avokaturën shtetërore për rastet me gjykata;
- Rishikimi i marrëveshjes me projektin EYE;
- Rishikimi i MM me donatorin gjerman DVV;
- Procedimi i vendimeve për pushim të lehonisë, vendimet për pensionime dhe vendimet e tjera;
- Takim me përfaqësuesit e DKA-Prizren, MeF dhe MSh;
- Përgatitja e dosjes për auditorin e performancës dhe vizita në shkollat partnere;
- Përgatitja e lëndëve për Agjencinë e AAAPARr-së;
- Paraqitja e obligimeve të mbetura nga viti 2020;
- Përgatitja e planifikimit të prokurimit për vitin 2020 në bazë të Ligjit të Buxhetit 2020;
- Planifikimi i buxhetit për gjashtë Qendrat e Kompetencës dhe Agjencinë;
- Buxheti i shpërndarë për Agjencinë dhe shkollat për menaxhim në bazë të Ligjit të Buxhetit 2020;
- Nënaloqimi i buxhetit për muajt janar-mars, 1/12 pjesë e buxhetit të vitit 2020;
- Regjistrimi i shpenzimeve të pagave dhe mëditjeve në tabelat për barazim;
- Shkresë drejtuar Ministrisë së Financave për marrjen e qasjeve të përdoruesve në

SIMFK të nënshkruar dhe vulosur nga Zyrtari Kryesor Administrativ;

- Përgatitja e raportit lidhur me numrin e punëtorëve sipas listës së pagave me orar të plotë dhe të shkurtuar të Agjencisë dhe shkollave nën menaxhim dhe dërgimi i saj te zyrtarët kompetentë **në MASH**;
- Përgatitja e raportit lidhur me barazimin e shpenzimeve të pranimit të mallit, barazimi i shpenzimeve në mallra dhe shërbime, shpenzimet komunale e të tjera dhe dërgimi i saj në MASHt;
- Përgatitja e deklaratës së disponueshmërisë së **fondeve për mirëmbajtjen e shkollave, të nënshkruar dhe vulosur nga** zyrtari kryesor administrativ;
- Nënshkrimi dhe dërgimi i PCF2 në MASH për vitin 2020;
- Ndarja dhe dërgimi i tabelës së plotësuar për ndarjen e mjeteve të të hyrave vetjake në kategorinë “Paga dhe mëditje” sipas buxhetit të ndarë për vitin 2020;
- Përgatitja e planit të rrjedhjes së parasë për vitin 2020;
- Tabela e regjistrimit të pasurisë për vitin 2020;
- Zotimi dhe tërheqja e Pety Cash-it për Agjencinë dhe shkollat;
- Përgatitja e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve për vitet 2021-2023 dhe dërgimi i saj te zyrtarët kompetentë **në MASH**;
- Menaxhimi i listës së pagave për çdo muaj;
- Analiza mujore e buxhetit në kategorinë paga dhe mëditje;
- Kërkesat e pranuar nga shkollat dhe dërgimi i tyre te zyrtarët kompetentë;
- Takim me administratorët e shkollave lidhur me çështjet financiare;
- Deklarimi i tatimit në burim dhe kontributeve për ekspertët me kontrata **të marrëveshjeve** për shërbime të veçanta për çdo muaj;
- Gjetja, përgatitja dhe dërgimi i lëndëve të **kërkuara dhe fotokopjimi i tyre tek**

- **auditori** i përgjithshëm në MASH;
- Nënlokimi i mjeteve të tremujorit të dytë të Agjencisë dhe Qendrave të Kompetencës për kategoritë “Mallra dhe shërbime” dhe “Shpenzime komunale”;
- Dërgimi i tabelës për grumbullimin e të hyrave vetjake dhe dërgimi te zyrtari i të hyrave në MASH;
- Barazimi i shpenzimeve të buxhetit të Agjencisë dhe shkollave nën menaxhim për periudhën janar-qershor 2020;
- Marrja pjesë në takimin e mbajtur në MASH lidhur me rekomandimet e Auditorit të Performancës;
- Bërja e nënalokimit për shkollat speciale për kategoritë **ekonomike** “Mallra dhe shërbime” dhe “Shpenzime komunale”;
- Pranimi i Qarkores Buxhetore 02/2020;
- Analiza e kategorisë ekonomike në paga dhe mëditje për muajt janar-qershor 2020.

Shkollat partnere të AAAPARr-së në procesin e validimit dhe akreditimit

Gjashtë shkollat partnere të AAAPARr-së janë shkollat e para në Kosovë që kanë aplikuar për procesin e validimit dhe akreditimit të programeve. Vjet Qendra e Kompetencës në Ferizaj është validuar dhe akredituar në dy profile që ka aplikuar në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), ndërsa në këtë vit është validuar dhe akredituar edhe Qendra e Kompetencës në Prizren, me gjashtë (6) profile. Ky është sukses i jashtëzakonshëm për Qendrat e Kompetencës dhe për arsimin e Kosovës në përgjithësi, duke synuar standarde dhe zhvillim të kënaqshëm të arsimit, të krahasueshme me vendet e zhvilluara evropiane.

Katër qendrat e tjera janë në fazën finale për t’u validuar dhe akredituar si institucione të AAP-së .



Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kualifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/201
Datë: 23.06.2020

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 08.06.2020 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Validohet dhe akreditohet Qendra e Kompetencës në Prizren me adresë, Ish Kazerma TMK-së, Dardani Prizren, për periudhën tri vjeçare 01.09.2020 deri 01.09.2023 me kualifikimet:
 - 1.1. Asistent në zyra të informimit dhe agjenci turistike, Niveli IV sipas KKK me 360 kredi të AAP
 - 1.2. Menaxhim dhe planifikim i ngjarjeve, Niveli IV sipas KKK me 360 kredi të AAP
 - 1.3. Nëpunës financiar, Niveli IV sipas KKK me 360 kredi të AAP
 - 1.4. Nëpunës industrial, Niveli IV sipas KKK me 360 kredi të AAP
 - 1.5. Nëpunës referent i kuadrove, Niveli IV sipas KKK me 360 kredi të AAP
 - 1.6. Udhëheqës i grupit turistik, Niveli IV sipas KKK me 360 kredi të AAP

Hapja edhe e tri Qendrave të Karrierës në Qendrat e Kompetencës

Në bazë të planit të punës së Agjencisë, të paraparë dhe me Planin Strategjik të Arsimit nga MASH, që nga fillimi i vitit kemi punuar për themelimin edhe të tri Qendrave të Karrierës në tri Qendrat e Kompetencës: Në Qendrën e Kompetencës Skenderaj, në Qendrën e Kompetencës Ferizaj dhe në Qendrën e Kompetencës në Prizren, duke i kompletuar kështu të gjitha shkollat tona partnere me zyra të Qendrave të Karrierës, komponentë kjo shumë e rëndësishme për informimin dhe orientimin e karrierës së nxënësve dhe përgatitjen e tyre për tregun e punës.

Qendrat për Karrierë do t'i ndihmojnë nxënësit e këtyre shkollave për të zhvilluar një karrierë të suksesshme arsimore, profesionale dhe jetësore, si dhe për ndërlidhjen më të mirë të shkollës me tregun e punës. Nxënësit e tashëm, nxënësit e ardhshëm, nxënësit e diplomuar, të rriturit që braktisin shkollën, bizneset, prindërit dhe komuniteti në përgjithësi do të përfitojnë nga këto Qendra për Karrierë. Qendrat, gjithashtu, do të luajnë rol të rëndësishëm për rritjen e regjistrimit të të rinjve në këto shkolla profesionale, do ta përmirësojnë vetëdijesimin e prindërve dhe do t'i forcojnë marrëdhëniet me sektorin privat/tregun e punës.



Memorandum mirëkuptimi me projektin ALLED2

Projekti “Harmonizimi i arsimit dhe aftësisimit me nevojat e tregut të punës”, faza II, (ALLED2), i financuar nga BE-ja me bashkëfinancim nga ADC - Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim, i realizuar nga ADA - Agjencia Austriake për Zhvillim dhe Shkolla ShMLT “11 Marsi”, Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAPARr), kanë lidhur memorandum të mirëkuptimit. Ky memorandum mbështet shkollat partnere të Agjencisë për modernizimin e programeve ekzistuese të projektit ALLED2 në sektorët përkatës, për zbatimin e mekanizmit kombëtar të sigurimit të cilësisë, për zhvillimin profesional të mësimdhënësve të AAP-së, për rishikimin e kurrikulave dhe për zhvillimin e standardeve të reja të punës. Pastaj për krijimin e bashkëpunimit të strukturuar midis AAP-së dhe sektorit privat i cili do ta harmonizojë arsimin dhe aftësimin me nevojat e tregut të punës dhe do ta rrisë punësueshmërinë në Kosovë.




Zbatimi i nivelit të pestë të kualifikimeve

Në kuadër të marrëveshjes me MASH-in dhe projektit të LuxDev për zbatimin e programeve të nivelit të pestë të kualifikimeve nga organizata PEARSON në Kosovë, jemi duke zbatuar programin e kualifikimit të “Asistentëve për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore”.

Sivjet diplomon gjenerata e tretë e asistentëve **të cilët** janë shumë të nevojshëm për trajtimin e rasteve të fëmijëve me nevoja të veçanta.

AAAPARr, në bashkëpunim me MASH-in dhe me projektin e financuar nga Qeveria e Luksemburgut, LuxDev, kanë vazhduar edhe këtë vit ofrimin e kualifikimit për nivelin V të arsimit sipas KKK (Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve) për “Asistentë për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore”. Gjenerata e tretë për këtë kualifikim realizohet në Qendrën Burimore “Përparimi” në Prishtinë dhe në Qendrën Burimore “Xheladin Deda” në Pejë për vitin shkollor 2019/2020.

Kualifikimi “Asistentë për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore” ka filluar nga shtatori i vitit 2017 me 54 kandidatë në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj, pastaj është vazhduar edhe me dy gjenerata të tjera në vitin 2018/19, me 75 kandidatë të regjistruar. Gjenerata aktuale, e treta, e vitit 2019/20, ka 52 kandidatë të regjistruar që kanë vijuar kualifikimin. Deri më tash këtë nivel të kualifikimeve e kanë arritur gjithsej 129 të diplomuar. Prej tyre deri më tash janë punësuar rreth 70 veta. Kualifikimi është i përshtatur sipas Kornizës Vetërregulluese të Pearson. Standardet e profesionit janë hartuar nga MASH dhe Oda Ekonomike e Kosovës, ndërsa kurrikulat dhe trajnimi i mësimdhënësve është bërë nga Pearson.



Marrëveshje bashkëpunimi me shkollën SEDU - Finlandë

Në bazë të marrëveshjes trevjeçare që kemi nënshkruar me Shkollën Profesionale SEDU nga Seynaioki i Finlandës, 14 nxënës të Qendrës së Kompetencës në Ferizaj e nisën një rrugëtim të ri për vazhdim të shkollimit në Finlandë për profilin “Asistent i kujdesit social dhe shëndetësor”. Kjo është një mundësi shumë e mirë që u ofrohet këtyre nxënësve për ta përfunduar shkollimin në Finlandë, pastaj për ta nisur punën.





Ministrja Bajrami vizitoi Agjencinë e AAPARr-së

Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Hykmete Bajrami, ka vizituar sot Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAPARr), ku është takuar me u. d. e drejtorit të përgjithshëm, Fikrije Zymberi dhe është njoftuar me stafin e këtij institucioni. Gjatë kësaj vizite Bajrami dhe Zymberi kanë diskutuar rreth këtij institucioni dhe për sfidat në arsimin profesional. Ministrja Bajrami ka ofruar mbështetjen e saj për këtë institucion.



Auditimi i performancës së AAAPARr-së nga Zyra Kombëtare e Auditimit

Efektiviteti i ndërlidhjes së arsimit dhe aftësisë profesionale me nevojat e tregut të punës

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Sa i përket auditimit të performancës, ku është përfshirë edhe Agjencia e Arsimit dhe Aftësisë Profesionale dhe Arsimit për të Rritur, zyrtarët e Agjencisë kanë bashkëpunuar ngushtë me ekipin e auditimit për t'i ofruar dokumentet e nevojshme lidhur me performancën e Agjencisë së AAPARr-së dhe shkollave partnere (Qendrave të Kompetencës), lidhur me efektivitetin e ndërlidhjes së arsimit dhe aftësisë profesionale me nevojat e tregut të punës.

Auditori ka identifikuar gjendje më të mirë për sa i përket zhvillimit të mësimin praktik si rrjedhojë e mbajtjes së punëtorive me pajisje adekuate dhe funksionale në katër IAAP-të që janë nën menaxhimin e Agjencisë (Qendra e Kompetencës në Prizren dhe ajo Ferizaj, Shkolla “11 Marsi”, Prizren, Shkolla “Shtjefën Gjeqovi”, Prishtinë).

Auditori i Performancës ka vërtetuar ngritje të kapaciteteve dhe performancë të mirë lidhur me disa komponentë të shqyrtuar prej tij si:

Zhvillim të kushteve adekuate për mësimin praktik në punëtoritë e IAAP-ve;

Monitorim të IAAP-ve lidhur me marrëveshjet e tyre që i lidhin me kompanitë e ndryshme për kryerjen e praktikës profesionale të nxënësve në ndërmarrje;

Gjendje më e mirë për sa i përket zhvillimit të mësimin praktik si rrjedhojë e punëtorive me pajisje adekuate dhe funksionale që kanë IAAP-të që janë nën menaxhimin e Agjencisë (Qendra Kompetencës në Prizren dhe ajo në Ferizaj; Shkolla “11 Marsi”, Prizren; Shkolla “Shtjefën Gjeqovi”, Prishtinë);

Gjendje më e mirë sa i përket realizimit të praktikës profesionale në biznese është regjistruar

në 4 IAAP-të që janë nën menaxhimin e Agjencisë. Kjo është arritur edhe për faktin se këto IAAP janë përkrahur shpeshherë nga donatorë të ndryshëm si në aspektin e furnizimit të tyre me pajisje të ndryshme për zhvillimin e mësimin praktik, po ashtu kanë pasur mbështetje të formave të ndryshme për mundësimin e realizimit të praktikës profesionale.

Vizita e Ministrit Likaj në AAAPARr

Ministri i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, z. Ramë Likaj, ka vizituar Agjencinë e Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur. Në këtë vizitë ai është pritur nga u. d. e Drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë, znj. Fikrije Zymberi.

Z. Likaj nga Drejtoresha e Agjencisë është **njoftuar** për aktivitetet e punës së Agjencisë dhe për sfidat nëpër të cilat është duke kaluar ky institucion.

Ministri shprehu gatishmërinë **për të bashkëpunuar dhe për ta mbështetur Agjencinë në mënyrë që të avancojmë përmirësimin e arsimit profesional.**



Marrëveshje bashkëpunimi me projektin EYE

Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAAPARr, Qendra e Kompetencës në Prizren, institucion arsimor publik, lidhin memorandum të mirëkuptimit me projektin **Rritja e Punësimit për të Rinj (EYE)**, i financuar nga Swiss Development Cooperation in Kosovo-SCO-K.

Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit (“MM”) është t’i përcaktojë qartë rolet dhe përgjegjësitë e secilës prej palëve lidhur me projektin “Ofrimi i kursit trajnues të shkurtër të orientimit për karrierë” për kualifikimin e stafit të Qendrave Shkollore për Karrierë (QShK) dhe grupeve të ndryshme të të rinjve dhe të rriturve.

Në veçanti, përmes kësaj MM-je midis palëve synohet:

- Akreditimi nga AKK i kursit trajnues të shkurtër të orientimit për karrierë;
- Ngritja e kapaciteteve të trajnerëve të Qendrës së Kompetencës në Prizren për ofrimin e kursit trajnues të shkurtër të orientimit për karrierë;
- Ofrimi i qëndrueshëm i kursit trajnues të shkurtër të orientimit për karrierë nga Qendra e Kompetencës në Prizren.

Përmes saj, synon shërbime të përmirësuara dhe me përfshirje sociale të orientimit për karrierë që u ofrojnë të rinjve informacion të menjëhershëm dhe fasilitojnë vendimet e tyre për zhvillim personal, duke synuar kryesisht të rinjtë në nivelin e shkollave të AAP-së.

Marrëveshje bashkëpunimi me organizatën DVV International

U nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit në mes të DVV International dhe Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin për të Rritur (AAAPARr).

Duke pasur parasysh rëndësinë e arsimit për të rritur si një instrument për ta nxitur pjesëmarrjen e njerëzve në zhvillimin kulturor, shoqëror, ekonomik dhe të qëndrueshëm, si dhe në uljen e varfërisë, institucionet e sipërpërmendura pajtohen që të bashkëpunojnë në fushën e arsimit profesional dhe arsimit për të rritur në Kosovë.

Qëllimi i projektit

Projekti ka për qëllim digjitalizimin e Qendrës së **Kompetencës** (QK) në Malishevë dhe asaj në Prizren dhe implementimin e mësimin online për profesionet IT dhe Marketing, sipas programeve për të rritur, **të licencuara nga MASH-i**. Gjithashtu, ky projekt do të shërbejë edhe për zhvillimin e standardeve të profesioneve të përmendura për nivelin 5 të kualifikimeve, të cilat do t'i paraprijnë zhvillimit të programeve dhe fillimit të implementimit të tyre në kuadër të shkollave të mesme profesionale dhe qendrave të kompetencës në nivel vendi.

Pas digjitalizimit të këtyre dy Qendrave të Kompetencës, përveç implementimit të mësimin online sipas programeve aktuale arsimore për të rritur, në fazën e mëvonshme - në pjesën e dytë të vitit 2020 - do të organizohen edhe aktivitete të tjera online (seminare dhe punëtori) nga mësimdhënës dhe trajnerë dhe ekspertë të cilët do të shërbejnë për zhvillimin e standardeve të profesioneve për nivelin 5 të kualifikimeve për profilet IT dhe Marketing.



Marrëveshje bashkëpunimi me organizatën KCDF

Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin e të Rriturve (AAPARR) ka lidhur marrëveshje me Fondacionin Kosovar për Zhvillim të Karrierës, “Kosovo Career Development Foundation” (KCDF).

- Qëllimi i marrëveshjes është promovimi i shkathtësive dhe kompetencave ndër të rinj;
- Promovimi i profesioneve të AAP-së dhe AARr-së në vend, në veçanti ndër të rinj dhe të reja;
- Njohja me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe promovimi i tyre në Kosovë;
- Përgatitja e materialeve mësimore për t’u përgatitur për garat e diturisë të orientuara kah shkathtësitë e tregut të punës;
- Ofrimi i trajnimeve për instruktorët e praktikës profesionale dhe mësimdhënësit e AAP dhe AARr-ve për përgatitjen e nxënësve për garat ndërkombëtare të shkathtësive;
- Ngritja e strukturave organizative dhe sigurimit të cilësisë për garat në nivel vendi, përfshirë ngritjen e sistemit informativ të garave për Kosovë;
- Organizimi i garave të shkathtësive në nivel vendi për vijuesit e mësimin të AAP-së, AARr-ve;
- Përgatitja e ekipeve të Kosovës për pjesëmarrje në gara ndërkombëtare;
- Ngritja e rrjetit të sponsorëve për sigurimin e pjesëmarrjes së përfaqësuesve nga AAP dhe AARr në gara ndërkombëtare;
- Organizimi i sesioneve informuese dhe këshillëdhënëse me ekspertë me përvojë lokale dhe ndërkombëtare;
- Lehtësimi i rrjetëzimit të nxënësve, instruktorëve dhe mësimdhënësvë me kolegë nga vende të tjera;
- Sigurimi i sponsorëve për financimin e pjesëmarrjes së nxënësve (shkollave) përfaqësuese në garat e organizuara ndërkombëtare (World Skills etj.),

respektivisht për ta siguruar pjesëmarrjen e nxënësve kosovarë në gara të nivelit ndërkombëtar;

- Promovimi i nxënësve fitues në nivel vendi;
- Ngritja e kanaleve informuese për promovimin e shkathtësive në nivel vendi dhe jashtë saj;
- Sigurimi i financimit për pjesëmarrje të përfaqësuesve të AAAPARr, KCDF, nxënësve dhe ekspertëve në forume të ndryshme regjionale dhe ndërkombëtare.

Fondacioni Kosovar për Zhvillim të Karrierës (KCDF) është promovuar si organizata kyçe në vend për ofrimin e shërbimeve me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe promovimin e AAP-së dhe të AARr-së për ndërlidhjen e AAP-së me nevojat e tregut të punës, për lehtësimin e dialogut në mes të punëdhënësve dhe institucioneve të AAP-së dhe AARr-së, për zhvillimin e standardeve të profesionit, për promovimin dhe për ngritjen e shkathtësive të nxënësve si dhe për orientimin profesional të nxënësve dhe edukimin e tyre në karrierë.

Marrëveshje bashkëpunimi në mes të DKA-së në Prishtinë dhe AAAPARr-së

Kjo marrëveshje është arritur në mes të Drejtorisë Komunale të Arsimit në Prishtinë dhe institucionit Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin e të Rriturve.

Qëllimi i kësaj marrëveshje është që përmes bashkëpunimit me moton “Nxënësit për nxënësit” t’u mundësohet të gjithë nxënësve të shkollave të Komunës së Prishtinës të kenë maska për mbrojtje nga Covid-19, të cilët nuk kanë mundësi për ta siguruar një maskë shumë përdorimesh. Këto maska do të qepen nga nxënësit e ShMLP “Shtjefën Gjeçovi” në Prishtinë - Drejtimi Konfeksion. Po ashtu, kjo është një mundësi shumë e mirë që këta nxënës t’i aplikojnë njohuritë e tyre teorike për realizimin e praktikës.



Qendrat e Kompetencës dhe respektimi i masave kundër Covidit

Drejtoresha e Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin e të Rriturve, Fikrije Zymberi, ka vizituar Qendrat e Kompetencës.

Menjëherë pasi nxënësit filluan vitin mësimor brenda objekteve shkollore, Zymberi i ka parë nga afër përgatitjet që janë bërë, duke bashkëbiseduar me mësimsdhënësit dhe nxënësit, për t'u siguruar nëse çdo gjë ishte në rregull për t'i zhvilluar orët mësimore sipas rekomandimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës dhe Ministrisë së Shëndetësisë.






Zhvillimi i mësimet online në Qendrat e Kompetencës në kushte të pandemisë Covid-19

Gjatë këtij viti shkollor ka qenë sfidë e madhe organizimi dhe mbajtja e mësimet për shkak të pandemisë të shkaktuar nga korona virusi Covid-19. Në rrethana të tilla edhe shkollat tona partnere janë detyruar që mësimin ta mbajnë online.

Shkollat me kohë i kanë marrë masat dhe janë përgatitur për mësim online duke u bazuar në udhëzues dhe rekomandime të Agjencisë dhe MASH-it.

Janë përdorur platforma të ndryshme për mbajtjen e mësimet online, siç janë: google classe room, Zoom, google meet etj.



Vizitënë Qendrate Kompetencës me zëvendës ministrin e MASH-it, z. Xhavit Rexhaj

Drejtoresha e përgjithshme e Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAAPARr-së), Fikrije Zymberi, me zv/Ministrin e MASH-it, Xhavit Rexhaj, vizituan Qendrën e Kompetencës në Skenderaj dhe atë në Malishevë. Qëllimi i vizitës ishte për t'i parë përgatitjet dhe zhvillimin e mësimin në kushte të pandemisë në këto Qendra të Arsimit Profesional. Njëkohësisht, shprehën gatishmërinë që së bashku me aktorët e tjerë të punojnë ngushtë për mbështetje të shkollave për të kaluar këtë gjendje sa më lehtë. Në bashkëbisedim me mësimdhënësit dhe me menaxhmentin e shkollave, zv/Ministri Xhavit Rexhaj ka thënë se është i kënaqur me përgatitjet që kanë bërë këto shkolla, duke i respektuar në tërësi udhëzuesit dhe protokollet për fillimin e mësimin në kushte pandemie.





Zbatimi i praktikës profesionale në Qendrat e Kompetencës

Qendrat e Kompetencës, **për nga organizimi dhe zbatimi i praktikës** profesionale të nxënësve, janë model në Kosovë **për shkak të kushteve të favorshme që kanë** dhe organizimit dhe menaxhimit të mirë. Ato janë të pajisura me punëtori shumë të avancuara, kabinete dhe laboratorë, **të cilat kushte** u ndihmojnë shumë nxënësve që ta **përfundojnë** pjesën e praktikës në profilet përkatëse dhe të marrin shkathhtësitë dhe kompetencat e duhura.

Edhe pjesa e praktikës profesionale në kompani realizohet mjaft mirë nga nxënësit e Qendrave të Kompetencës falë organizimit të duhur të menaxhmentit dhe bashkëpunimit të ngushtë që kanë me kompanitë dhe bizneset e ndryshme.

Përkundër faktit që ky vit ka qenë mjaft i vështirë dhe sfidues **për shkak të pandemisë të shkaktuar nga** korona virusi Covid-19, realizimi i praktikës profesionale nga nxënësit ka vazhduar në shkollë dhe në kompani.





Nxënësit e shkollës “Shtjefën Gjeçovi” i dhuruan MASH-it, 200 maska anti-COVID

Nxënësit e Shkollës së Mesme të Lartë Profesionale “Shtjefën Gjeçovi” në Prishtinë, të shoqëruar nga mësimdhënësit e tyre dhe Drejtori i shkollës, Blerim Gërvalla, i kanë dhuruar Ministrisë së Arsimit një donacion prej 200 maskave, të punuara nga nxënësit e kësaj shkolle.

Në ceremoninë e dhurimit të donacionit u.d. Drejtoresha e Agjencisë së Arsimit dhe Aftësimin Profesional, znj.Fikrije Zymberi, ndër të tjera shprehu mbështetjen e vazhdueshme për shkollat partnere dhe falënderoi nxënësit për punën dhe përkushtimin e tyre.

Në emër të Ministrit Ramë Likaj, nxënësit dhe mësimdhënësit e shkollës për këtë donacion i falënderoi këshilltari, Gëzim Berisha, i cili ndër të tjera theksoi se, Arsimi Profesional mbetet një nga prioritetet e MASH.

Ndërsa, Sekretari i MASH, Agim Berdyna theksoi se, MASH do të përkrahë gjithmonë Arsimin dhe Aftësimin Profesional, në mënyrë që nxënësit të kenë mundësi dhe kushte më të mira për të fituar shkathtësitë e nevojshme për tregun e punës.



Marrëveshje me organizatën DEKRA Akademi

Në ambientet e Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur u nënshkrua marrëveshja e memorandumit të bashkëpunimit në mes të AAAPARr-së - Qendra e Kompetencës, Ferizaj dhe DEKRA Akademi në Kosovë.

AAAPARr dhe DEKRA Akademi u pajtuan të bashkëpunojnë në fushën e aftësimin, trajnimit, kualifikimit dhe pajisjen e infermierëve në komunitet me licencë gjermane të infermierit dhe punësimin e tyre.

Kjo MM do t'i përmirësojë kompetencat ndërkombëtare të bashkëpunimit për të dyja palët. Qëllimi i kësaj MM është t'i definojë rolet dhe përgjegjësitë e të dy palëve në lidhje me bashkëpunimin që synon për nxitjen e zhvillimit të bashkëpunimit në fushën e infermierisë dhe kujdesit social dhe shëndetësor dhe krahason sistemet arsimore dhe profilet në fushën e infermierisë, kujdesit social dhe shëndetësor. Mundëson aftësimin, trajnimin, kualifikimin dhe punësimin e kandidatëve të cilët janë pjesë e projektit të DEKRA Akademi.



Vizita e Ministrit të MASH-it, z. Ramë Likaj, në ShMLP “Shtjefën Gjeçovi”, Prishtinë

Ministri i MASH-it, z. Ramë Likaj, me u. d. Drejtoreshën e Agjencisë së AAPARr-së vizituan Shkollën e Mesme Profesionale “Shtjefën Gjeçovi” në Prishtinë. Me këtë rast Ministri Likaj premtoi përkrahje të fuqishme për shkollën dhe për të gjithë sistemin e arsimit dhe aftësisimit profesional, si një nga prioritetet e ministrisë që udhëheq, në mënyrë që të rinjtë tanë të jenë të përgatitur dhe të aftë për tregun e punës.



AAAPARr fiton projekt për mobilitet në AAP nga Komisioni Evropian

Publikimi i rezultateve EAC/S54/2019, skema e lëvizshmërisë pilotë në arsim dhe aftësim profesional për Ballkanin Perëndimor.

Aplikacioni i projektit MoVET - lëvizshmëria për AAP në Evropë - u miratua nga Komisioni Evropian me rezultat të përgjithshëm prej 89 pikësh. Projekti ka të bëjë me mundësinë e mobilitetit apo lëvizshmërinë e nxënësve dhe mësimeve të shkollave të mesme të larta profesionale dhe materialeve shkollore me vendet e Evropës.



AAAPARr harton pakon kurrikulare dhe pakon e trajnimit për orientim në karrierë

Në bashkëpunim me projektin EYE, pas një pune dhe angazhimi të madh, me grupe punuese, kemi hartuar dhe përfunduar paketën kurrikulare për programin kualifikues për Këshilltar në Karrierë, në nivelin IV të KKK-së. Kjo paketë përfshin:

- Kornizën kurrikulare
- Planin mësimor
- Materialin mësimor
- Instrumentet e vlerësimit dhe
- Rastet studimore.


Ndërsa objektivi e dytë e këtij bashkëpunimi të frytshëm ka qenë Trajnimi i trajnerëve (T o T) për programin kualifikues për Këshilltar në Karrierë. Trajnimi ka zgjatur pesë javë, me ç ‘rast sot kanë përfunduar trajnimin dhjetë mësime të katër Qendrave të Kompetencës nga: QK Malishevë, QK Skenderaj, QK Prizren dhe QK Ferizaj, duke ngritur kështu kapacitetet në shkolla për këtë komponentë mjaft të rëndësishme të arsimit profesional dhe jo vetëm.




Takim online organizuar nga EVBB me Agjencinë Evropiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (EU-OSHA)

Drejtoresha e Agjencisë znj. Fikrije Zymberi, ka marrë pjesë në takimin online të organizuar nga EVBB- Asociacioni evropian i instituteve për trajnim profesional në lidhje me projektin OSHVET (Siguria dhe shëndeti në punë – sektori i AAP-së).

Këtë projekt e udhëheq EU- OSHA (Agjencia evropian për sigurinë dhe shëndetin në punë). EU – OSHA, tashmë ka zhvilluar disa iniciativa për të integruar sigurinë dhe shëndetin në punë në edukim/rini. Objektivi i këtij projekti është të rris ndërgjegjësimin për rëndësinë e sigurisë dhe shëndetit në punë për shkollat profesionale, në vendet e BE-së dhe vendet e Evropës Juglindore, duke siguruar që Mësimdhënësit dhe nxënësit/studentët të kenë qasje të lehta në informacionet ekzistuese për praktikat e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe kontakte të dobishme në nivele kombëtare dhe rajonale.





Konferencë online “ Cilësia në AAP në mjedisin POST – COVID: Rasti i Bequal. App”

AAAPARr, mori pjesë në konferencën e organizuar nga Asociacioni Evropian i Insiteve për Trajnim Profesional (EVBB). Në kuadrin e projektit Erasmus + “Bequal.app”, EVBB ka krijuar së bashku me partnerët evropianë një platformë kushtuar sigurimit të cilësisë dhe krahasimit në arsimin dhe aftësimin profesional dhe në mësimin e bazuar në punë (për institucionet arsimore dhe kompanitë). Kjo platformë ofron burime dhe mjete krahasuese, për sigurimin e cilësisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të organizatave të përfshira në arsimin dhe aftësimin profesional dhe në mësimin në bazë të punës.

Në këtë ngjarje u prezantuan mjetet e vlerësimit të aplikacionit Bequal.app për publikun, do të jetë gjithashtu mundësia për të adresuar çështje të tjera në lidhje me pandeminë, të tilla si ndikimi i Covid-19 në aktivitetet e të mësuarit të bazuar në punë në Evropë, rëndësia e Sigurisë dhe Shëndetit në punë në AAP, përgjigjet nga EQAVET dhe nevoja e Sigurimit të Cilësisë në Dixhitalizimin e Arsimit.

Save the Date: EVBB Online Conference "QUALITY IN VET IN THE POST-COVID ENVIRONMENT - the case of Bequal.app" (14 December 2020)

If you cannot view this e-mail correctly, please click [here](#).

EVBB
EUROPEAN ASSOCIATION OF
INSTITUTES FOR VOCATIONAL TRAINING

European Association of Institutes
for Vocational Training
Association Européenne des Centres
de Formation Professionnelle

bequal.app
Benchmarking for Quality Assurance in
Vocational Training and Quality Assurance

EUROPEAN ONLINE CONFERENCE
"QUALITY IN VET IN THE POST-COVID ENVIRONMENT"
the case of Bequal.app
14-12-2020, 09:30 to 13:00 (CET)

>> **14 December 2020 (9:30 - 13:00 CET)** <<
Registrations open

Dear Colleagues,

You are warmly invited to participate in the online event
**"QUALITY IN VET IN THE POST-COVID
ENVIRONMENT - the case of Bequal.app"** that I will be
hosting on December 14th, 2020.

In the framework of the **Erasmus+ project
"bequal.app"**, EVBB has created together with our
European partners a platform dedicated to **quality
assurance and benchmarking in vocational**

Theodor Grassack
Secretary General EVBB
Avenue de la Renaissance 1
B-1050 Bruxelles

Left sidebar (Outlook navigation pane):
 - Favorites: AAAPARr
 - Folders: Inbox (12), Junk Email (9), Drafts, Sent Items, Deleted Items, Archive, Notes
 - AAAPARr: Jemir Berisha (Information, Tue 12/9), Fikrije Zymber (SAVE THE DATE: Kick off Event for the 'Sa...', Tue 12/9), Fikrije Zymber (Save the Date: EVBB Online Conferenc..., Thu 12/7), Jemir Berisha (Takimi ne Zoom, Mon 12/7), Fikrije Zymber (EU-ODNA AVETAE as the "National cop...", Sat 12/9), Fikrije Zymber (Results of EAC/SSA/2019 - Pilot VET mobil..., Thu 12/3), Fikrije Zymber (Publication of results - EAC/SSA/2019 - PL..., Thu 12/3), Fikrije Zymber (Publication of results - EAC/SSA/2015 - ..., Thu 12/3)

Marrëveshje bashkëpunimi me BSCK

AAAPARr ka arritur marrëveshje bashkëpunimi me organizatën Business Support Centre Kosovo (BSCK) për mbështetjen e të rinjve/nxënësve për punësim në sektorin e energjisë. Ky projekt ka të bëjë me përmirësimin e qasjes në tregun e punës për grupet e të rinjve/nxënësve dhe të rriturve përmes punësimit të tyre.



Themelohet Qendra e Karrierës në Qendrën e Kompetencës, Skenderaj

Është hapur Qendra e Karrierës në Qendrën e Kompetencës, Skenderaj. Të pranishëm ishin Ministri i MASH-it, z. Ramë Likaj, Drejtoresha e AAAPARr-së, znj. Fikrije Zymberi dhe Kryetari i Komunës së Skenderajt, z. Bekim Jashari. Gjithashtu të pranishëm ishin përfaqësues nga projekti EYE dhe menaxhmenti i Qendrave të tjetra të Kompetencës.

Projekti është financuar nga AAAPARr dhe përgatitja është bërë nga nxënësit dhe mësuesit e Qendrës së Kompetencës.

Roli dhe rëndësia e Qendrës së Karrierës është e madhe, pasi në punën e vet përfshin informimin dhe orientimin e nxënësve për mundësitë e karrierës së tyre, informata për tregun e punës, praktikës profesionale dhe punësimit, ndërlidhjen e shkollës me kompani dhe shumë aktivitete të tjera.






Takim pune me Dhomën Zejtare të Koblez – Gjermani (HWK)

U mbajt takim online me Dhomën e Zejtarëve (HWK) Koblez, nga Gjermania, të pranishme ishin edhe Oda e Ndërmarrësve Zejtarëve të Prizrenit si dhe Shkolla Profesionale 11 Marsi Prizren.

Në këtë takim nga pala Gjermane morën pjesë Z. Mey Thorsten Zj. Evelina Parvanova Z. Emil Vasilev. Znj. Migena Sejdini. Nga institucionet tona ishin : Drejtoresha gjenerale e AAAPARr-së Zj. Fikrije Zymberi, Drejtori i Sh.M.L.P. “11Marsi” Prizren, Z Xhelal Susuri, nga Oda zejtare e Prizrenit Z Afrim Tejeci, Z Fatir Berzati, si dhe Z. Afrim Rada.

Qëllimi i nismës ka të bëjë me Arsimin Profesional të afërt me praktikën në disa profesione tek Ndërmarrësit të fushës Elektroteknikë dhe Teknik Sanitarë, Ngrohje dhe Klimatizim.

Dhoma Zejtare HWK Koblenz, përfaqëson rreth 19500 Sipërmarrje në fushën e Zejtarisë për zonën veriore të Landit Rheinland-Pfalz të Gjermanisë dhe është një mundësi shumë e mire që të kemi bashkëpunim të ngushtë.



Tirazhi: 520
Shtypi: BLENDI - Prishtinë

